

AKT THEMELUES

I SHOQERISE TREGTARE PRIVATE

“ ECO BIOMASS ” Sh.p.k

Unë Davide Lo Conte, i biri i Gabrielle, i datëlindjes 19.08.1970 me numer personal Italiane CA04921JF,dhe i pajisur me leje qendrimi me numer personal ID: H03818003N, banuese Rr.”Dajti”Ndërtesa 27,Njësia Administrative Linzë,Tirane

Mbështetur në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ” dhe në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”, sot më datë 11.11.2022 krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**ECO BIOMASS**”, me aktin themelues të saj si vijon :

FORMIMI

NENI 1

Formohet shoqëria private e quajtur “ **ECO BIOMASS** ” Shoqëria do ti nënshtronet legjislacionit Shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtronen legjislacionit ku do të ketë selinë dega.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e shoqërise tregtare private “ **ECO BIOMASS** ”, do të jetë :



Lagija "Barrikada", Rruga "Ismail Klosi", "Ish-Kombinati Tekstileve" godinë dy katëshe, me numër pasurie 19/164, Zona kadastrale 8501

Ajo mund te çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e ortakut themelues të saj.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në fushën e:
Fabrika e prodhimit të peletit dhe briketit. Grumbullimi, menaxhimi dhe përpunimi i mbetjeve të drurit. Import – eksport. Në fushën e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të lëndës drusore, prodhimit të produkteve dhe gjysëmfabrikave në dru, dyer, dritare, parket, mobilje dhe produktet e tyre të energjisë nga "ECO BIOMASS" me shumicë dhe pakicë. Importe-Eksport te nenprodukteve te drurit, pelet, tallash etj. Impianti për prodhimin e peletit & peletit, briketave, druve të zjarrit. Grumbullimi, menaxhimi dhe përpunimi i mbeturinave të drurit Import-eksport Pelet. Prodhimi, përpunimi dhe tregtimi i lëndës drusore, prodhimi i Produkteve gjysëm të gatshme nga druri, dyer dhe dritare të lëvizshme etj., si dhe tregtia e tyreme shumicë dhe pakicë blerje dhe shitje Përmirësimi, shfrytëzimi, përpunimi i pyjeve e tregtimin, mbrojtjen dhe përmirësimin e lëndës drusore livadhe dhe kullota, mbrojtje nga zjarri i pyjeve eparazitët, përmirësimi i florës dhe faunës së njërsë prej zonave, prodhimi dhe tregtimin e fidanëve të arrës dhe pyllit, ekonomise, transportit, etj si edhe. Transport mallrash per vete, per te trete e me qira. Transport nderkombetar mallrash per te trete e me qira

NENI 4

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të sigurojë mjetet e nevojshme dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkaku.



KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare private “**ECO BIOMASS**” do të jetë **2,400,000 Lek** (Dy milion e katerqind mij) lek dhe do të përbëhet nga kuotat e ortakeve themelues të shoqërisë. Kapitali përbëhet nga 1 kuotë dhe vlera nominale e një kuote është e barabartë me 2,400,000. Znj.Davide Lo Conte zotëron 1 kuote me vlerë 2,400,000 lek qe perbene 100% te kapitalit themeltar

Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet sipas vendimit të ortakeve themelues. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

NENI 7

Ortaku i vetëm duhet të bëjë përpjekje përritjen e potentialit ekonomik të shoqërisë, të ruajë sekretin e saj dhe të mos dëmtojë interesat e personave të tjera dhe të shoqërisë.

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 8

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, Znj.Matilda Hyseni , e cila është përfaqësuesi ligor i saj. Afati i emërimit të administratorit është për një periudhë kohore prej **5** vjet me të drejtë ripërtëritje.

NENI 9

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakeve themelues të shoqërisë, Z.Davide Lo Conte 100/100.

NENI 10

Ortaku themelues ka të drejtë të emërojë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale të shoqërisë. Ai ka të drejtë të caktoje financier, likuidator për problemet e shoqërisë, si edhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të shoqërisë.



NENI 11

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykojen dhe zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 12

Shoqëria ka vulën e saj në madhësi të zakonshme, me tekstin për rrethin e saj.

NENI 13

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI 14

Ky akt themelimi përpilohet në tre kopje me vlerë të barabartë, nga të cilat njëra depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, njëra në zyrën e Tatimeve dhe kopja e tretë mbahet në dokumentat e shoqërisë tregtare " Biomass "

Akti i themelimit nenshkruehet rregullisht nga ortaket themelues.

ORTAKU THEMELUES TE SHOQERISE

"ECO BIOMASS"

Davide Lo Conte

DAVIDE LO CONTE

I Cef